

There are no translations available.

Kujtohet me marshim dhe ceremoni greva e përgjithshme e 16 majit 1991

Dita e kthesës së madhe për Shqipërinë



Dëshira dhe gadishmëria për të përmbysur sistemin ishte formëzuar. Në sajësën e partisë-pushtet, mbështetja në forcat e veta kishte sjellë pakënaqësi të klasa punëtore. Rinia nga njëra anë dhe klasa punëtore nga ana tjetër, dy shtylla të fuqishme të pas viteve '90 do të kishin një qëllim, rrëzimin e diktaturës.

16 dhjetori 1990

Punëtorët e minierës në Qafë Bari organizuan një grevë ku paraqitën këto kërkesa: ngritja e pagave e cila pasohej nga kërkesën për përmirësimin e kushteve të punës, fjetjes dhe veshmbathjes e ushqimit. Kanë mjaftuar këto kërkesa që të kishte reagime të pazakonta nga forcat e rendit.

Greva e Valiasit

Minatorët e Valiasit ishin në pritje të kërkesave të tyre drejtuar instancave shtetërore. Pas heshtjes nga ana e shtetit, minatorët u mbledhën para minierës. E shtuna e 12 janarit 1991 ishte një ditë plot tension. Parrullat lajmëronin protesta. Këmbëngulja ishte e madhe. Pavarësisht se më 16 janar 1991 erdhi përgjigja se u miratua kërkesa e grevistëve për të rritur 60 përqind pagat e tyre, po merrte shtat lëvizja e minatorëve e cila kërkonte ndryshimin e pushtetit. Kështu do të konturohej një tjetër greve që në histori do të njihet si greva e urisë e minatorëve të Valiasit. U futën në minierë për jetë a vdekje. Miniera e Valiasit u bë simboli i lëvizjes punëtore në Shqipëri, sepse aty filloi zanafilla e krijimit të një lëvizje të re punëtore, që do të sillte më vonë themelimin e Sindikatës së Minatorëve të Shqipërisë. Për herë të parë një lëvizje punëtore, bashkë me forcat demokratike solli ndryshimin e regjimit, që për BSPSH është një ngjarje fundamentale për kombin shqiptar. Greva e 16 majit, ishte lëvizje brilante në ato ditë të vështira për fatet e Shqipërisë, ndërsa greva e urisë së minatorëve të Valiasit ishte aksioni i shtresës më vitale të punonjësve shqiptar. Ky ishte një moment historik që përsëritet vetëm një herë. Për këto kontribute madhore, ish Presidenti Berisha më 24.05. 1995 me Dekret nr 1101 do t'i akordonte medaljen "Pishtar i Demokracisë" kolektivit të minatorëve të pellgut qymyrguror të Tiranës. Berisha do t'i akordonte 49 personave të cilat u bënë promotor të ndryshimit, medalje me motivacion "Për kryerjen e aktit sublim të grevës së urisë, për kontributin në rrëzimin e regjimit diktatorial komunist".

Ndërsa BSPSH-së i është akorduar "Medalja e Artë e Shqiptonjës" nga Presidenca, për kontribut të çmuar në lëvizjen demokratike dhe veçanërisht në protestën e qytetarëve të Tiranës të 20 shkurtit 1991 për përmbysjen e simboleve komuniste, si moment i rëndësishëm në ndryshimet progresive në vend.

Marshim në nderim të grevës së përgjithshme







